




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve –Ministartstvo za Finansija, Rada i Transfera Ministry of Finance,  
Labor and Transfers


*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit**

# **Anketa e Mbeturinave Industriale 2020**



Prishtinë, 2021





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve –Ministartstvo za Finansija, Rada i Transfera Ministry of Finance,  
Labor and Transfers

*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit**

# **Anketa e Mbeturinave Industriale 2020**



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA  
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Prishtinë, 2021

Botues: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK)

Data e botimit: Dhjetor, 2021

© Agjencioni i Statistikës së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mund të qasenë përmes ueb-faqes së ASK-së:

<http://ask.rks-gov.net>

## Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Mbeturinave Industriale (AMI) për vitin referues 2020, si anketë e rregullt vjetore.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi statistikor është që të ofrojë të dhëna statistikore për mbeturinat e gjeneruara nga sektorët industrialë në Kosovë. Ky hulumtim është kryer sipas NACE rev.2.

Rezultatet e paraqitura në këtë publikim janë burim i rëndësishëm statistikor për mbeturinat e gjeneruara dhe të përpunuara nga sektorët e industrisë; B, C, D, E, F, G-U.

Metodologjia e aplikuar në këtë hulumtim është në përputhje me: Rregulloren (EC) Nr. 2150/2002 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 25 nëntorit 2002 mbi statistikat e mbeturinave; Listës Evropiane të Mbeturinave; dhe Ligjit për Mbeturina në Kosovë, Nr. 04 / L-060.

Falënderimet i dedikohen ekspertit nga GOPA, Volker Küchen (ARGUS GmbH, Berlin) për mbështetje profesionale.

Publikimion përgatiten:

- Bajrush Qevani - Drejtor i Departamentit të Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
- Haki Kurti, MSc. - Shef i Divizionit të Statistikave të Mjedisit
- Flutura Shosholli - Zyrtare e Statistikave të Mjedisit
- Ismet Ahmeti - Zyrtar i Statistikave të Mjedisit

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dergoni në adresën e ueb faqes (ueb faqja e departamentit prodhues).

Dhjetor, 2021

Zv. Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së  
Ilir T. Berisha

## Lista e shkurtesave dhe simboleve \_\_\_\_\_

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
LoW	-	Lista e Mbeturinave
NACE Rev.2	-	Klasifikimi i Veprimatrive Ekonomike
EWStat.		
Classification	-	Katalogu Statistikor Evropian i Mbeturinave
Kg	-	Kilogram
T	-	Ton
%	-	Përqindje
:	-	Të dhënat nuk janë në dispozicion

## Përmbajtja

---

1. Informacione të përgjithshme.....	8
2. Objektivat dhe metodologjia e anketës .....	8
2.1. Objektivi .....	8
2.2. Metodologjia .....	8
2.2.1.Korniza e anketës.....	8
2.2.2.Mbledhja e të dhënave .....	9
3. Definicionet.....	9
4. Rezultatet e Anketës së Mbeturine Industriale, 2020 .	10
5. Shtojca 1: Pyetësi.....	13

## 1 Shpjegime Metodologjike

### 1. Informacione të përgjithshme

Anketa e Mbeturinave Industriale (AMI) në Kosovë u realizua sipas NACE Rev.2, që njëkohësisht është dhe klasifikim statistikor i aktiviteteve ekonomike. Sipas listës së mbeturinave (LoW), ato janë klasifikuar si të rrezikshme dhe jo të rrezikshme. Njësi raportuese janë të gjitha kompanitë me 10 e më shumë punëtorë. Kompanitë e përfshira janë klasifikuar nga NACE Rev.2 në sektorët e aktiviteteve vijuese:

- B - Xehetari dhe Guroret;
- C – Prodhimi;
- D - Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar;
- E - Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim të mbeturinave dhe rregullim toke;
- F – Ndërtimtaria;
- G-U - Sektorët e shërbimeve.
- 

### 2. Objektivat dhe metodologjia e anketës

#### 2.1. Objektivi

Objektivi i AMI 2020 është të ofrojë të dhëna statistikore për mbeturinat e gjeneruara nga sektorët industrialë në Kosovë, sipas NACE rev.2. Rezultatet e paraqitura në këtë publikim janë burim i rëndësishëm statistikor për mbeturinat e gjeneruara dhe të përpunuara nga sektorët e industrisë: B, C, D, E, F, G-U.

Gjithashtu, me publikimin e AMI 2020 janë përbushur sado pak kërkesat e shfrytëzuesve për statistikat e mbeturinave nga sektorët e lartpërmendur të industrisë në nivel vendi.



Metodologjia e anketës është në harmoni me rregulloret dhe ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare, si vijon: Rregulloren (EC) Nr. 2150/2002 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 25 nëntorit 2002 mbi statistikat e mbeturinave; Listës Evropiane të Mbeturinave (LoW); dhe Ligjit për Mbeturina në Kosovë, Nr. 04 / L-060.

## **2.2. Metodologjia**

### **2.3. Korniza e anketës**

Mbledhja e të dhënave është kryer gjatë muajit korrik 2021, ndërsa intervistat me biznese janë realizuar sipas metodës tradicionale “ballë për ballë”.

Plani i punës ka pasur këto faza:

- Fazën përgatitore;
- Përgatitjen e mostrës;
- Trajnimin e anketuesve;
- Mbledhjen e të dhënave;
- Përpunimin e të dhënave dhe
- Publikimin e rezultateve

Gjatë fazës përgatitore janë kryer këto aktivitete: mostra, pyetësi, variablat, udhëzuesi për anketues, trajnimi i anketuesve dhe ndërtimi i bazës së të dhënave. Mostra është përgatitur sipas Regjistrit Statistikor për Biznese.

Trajnimi njëditor për të gjithë anketuesit është mbajtur në ASK. Anketuesit kanë qenë të angazhuar për mbledhjen e të dhënave nga terreni.

Mostra e AMI 2020 është përbërë prej 845 bizneseve. Numri i përgjithshëm i bizneseve, që janë përgjigjur në anketë ka qenë 655. Njësi raportuese në anketë kanë qenë kompanitë me dhjetë (10) e më shumë punëtorë.

### 2.3.1. Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave është realizuar nëpërmjet intervistimit “ballë për ballë” me menaxherët e kompanive industriale, bazuar në pyetësor (Shtojca 1). Të gjithë pyetësorëve u është bërë kontrolli i cilësisë në ASK.

## 3. Definicionet

3.1 Mbeturina industriale: janë mbeturinat e gjeneruara nga sektorët e industrisë.

**Mbeturina të rrezikshme:** janë mbetje, që sjellin dëm dhe rrezik për shoqërinë. Me këto mbeturina tregohet rrezik domethënës për shëndetin njerëzor, ose për mjedisin, kur nuk menaxhohet në mënyrë adekuate. Mbeturinat e rrezikshme janë të: ndezshme, gërryese, reaktive, ose toksike. Mbeturinat e rrezikshme janë mbeturinat, që kanë të paktën një nga karakteristikat e përshkruara si në vijim: shpërthyese, oksidante, djegëse, irrituese, toksike, kancerogjene, gërryese, infektuese, teratogjerike, mutagjene, emetuese, gazra toksike në kontakt me ujin, ajrin ose një acid, ka të ngjarë të prodhojë substanca tjera të rrezikshme, dhe eko-toksike.

#### 4. Rezultatet e Anketës së Mbeturinave Industriale 2020

Rezultatet nga AMI 2020 tregojnë se gjithsej: sasia e mbeturinave industriale, të gjeneruara për vitin 2020, ishte 2 137 015 ton, krahasuar me vitin 2019 ka qenë 2 % më e lartë. Ndërsa sasia e mbeturinave të dërguara diku tjetër ishte 38 163 ton, sasia e mbeturinave të deponuara ishte 1 918 457 ton, sasia e mbeturinave të ricikluara ishte 180 022 ton, sasi e mbeturinave të djegur ishte 453 ton dhe gjithsej sasia e mbeturinave të përpunuara<sup>1</sup> ishte 2 137 095 ton, ose 2 % më shumë se në vitin 2019.

Të dhënat e vitit 2020 tregojnë se sasia më madhe e mbeturinave të gjeneruara sipas sektorëve të industrisë ka qenë nga sektori D me, 1 361 595 ton, krahasuar me vitin 2019 ka qenë 3.8% më e lartë.


---

<sup>1</sup> Përpunim i mbeturinave – operim, ku rezultati kryesor i të cilit është vënia në shërbim e mbeturinave për qëllime të dobishme, duke zëvendësuar materialet tjera të cilat përndryshe do të duhej përdorur për të plotësuar një funksion të caktuar, apo përgatitja e mbeturinës për të plotësuar ato funksione në ndonjë impiant apo ekonominë e gjerë. Shtojca II (Lista R – lista e operimeve potenciale).


**Tab. 1: Gjithsej sasia e mbeturinave industriale të gjeneruara nga sektorët e industrisë; B, C, D, E, F, G-U.**

NACE Rev.2	Mbeturina të gjeneruara	Trajtimi i mbeturinave nga kompanitë gjeneruese			Mbeturina të dërguara diku tjetër	Gjithsej mbeturina të përpunuara*
		Mbeturina të djegura	Të ricikluara	Të deponuara		
B	516.599	306	177.626	327.004	11.599	516.535
CA	217.174	0	:	211.060	6.114	217.174
CB	196	:	5	180	11	196
CC	2.800	87	1.021	1.469	281	2.858
CD	1.100	:	:	1.100	:	1.100
CE	550	:	:	550	:	550
CF	:	:	:	:	:	:
CG	10.933	40	424	6.248	4.281	10.993
CH	9.392	19	301	3.641	5.431	9.392
CI	:	:	:	:	:	:
CJ	37	:	26	:	11	37
CK	436	:	201	:	235	436
CL	:	:	:	:	:	:
CM	1.196	:	66	1.120	10	1.196
D	1.361.595	:	:	1.351.610	9.985	1.361.595
E	7.666	:	111	7.515	66	7.692
F	4.440	0	202	4.110	128	4.440
G-U	2.900	:	40	2.850	10	2.900
<b>Gjithsej</b>	<b>2.137.015</b>	<b>453</b>	<b>180.022</b>	<b>1.918.457</b>	<b>38.163</b>	<b>2.137.095</b>

**Graf. 1: Mbeturinat e gjeneruara sipas sektorëve: B, C, D, E, F, G-U, 2020**



**Grafiku 2: Mbeturinat e përpunuara sipas sektorëve: B, C, D, E, F, G-U, 2020**



## **5. Aneks. 1: Pyetësi**



**Katalogimi në botim (CIP)**  
**Biblioteka Kombëtare e Kosovës – “Pjetër Bogdani”**

311:63(496.51)"2020"

Anketa e mbeturinave industriale 2020 / Publikimin e përgatiten : Bajrush Qevani,... etj. - Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2021. 1 burim elektronik - (14 f.) : ilustr. ; 28 cm.

Bujqësia -- Statistika – Kosovë

**ISBN 978-9951-22-836-7**

Aleph [000103839]



## Agjencia e Statistikave te Kosovës: Përshkrim i shkurtër

---

Agjencija e Statistikave të Kosovës, është institucion profesional, i cili vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019.

Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Misioni i Agjencionit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

**Adresa: Agjencia e Statistikave të Kosovës**

Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

**Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129

**Kryeshefi Ekzekutiv:** +383 (0) 38 200 31 112

**Fax:** +383 (0) 38 235 033

**E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)

**Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-22-836-7



9 789951 228367